Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

152/17
16.06.17

PSH. nr. 152/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 26 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje **Nuhi Paçarizi–Kryetar, Blerim Dina-Referues dhe Tefik Sylejmani-Anëtar,** duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 152/17, të parashtruar nga operatori ekonomik "PE-VLA-KU" sh.p.k. me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka –pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Komuna e Gjakovës, në seancën e dt. 13 qershor 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **HEDHET ,** si e palejuar ankesa e OE "PE-VLA-KU" sh.p.k. me seli në Prishtinë, nr. të protokollit 152/17, kundër vendimit të autoritetit kontraktues Komuna e Gjakovës, për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka –pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, për shkak se i njëjti nuk ka mund të dëshmoj interes juridik material konfrom nenit 111 par. 1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP-së pasi i njëjti është i papërgjegjshëm

II. **VËRTETOHET,** vendimi i autoritetit kontraktues Komunës së Gjakovës, njoftim për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka –pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, si i bazuar.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues "PE-VLA-KU" sh.p.k. me seli në Prishtinë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues– Komuna e Gjakovës, më dt. 29 dhjetor 2016, ka bërë *Njoftim për kontratë,* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka –pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511.

Për aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, kanë ofertuar nëntë (9) operator ekonomik, ku sipas komisionit vlerësues 1 (një) operator ekonomik i plotëson kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 8 (tetë) operator ekonomik janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues më 08 maj 2017, ka publikuar njoftimi për dhënie të kontratës.

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim të dt. 25 maj 2017, operatori ekonomik "PE-VLA-KU" sh.p.k. me seli në Prishtinë, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 1, nenit 7, nenit 59, nenit 60 dhe nenit 72, si dhe nenit 108/A të LPP-së.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent

Ankesa është e palejuar

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 29 maj 2017, ka autorizuar eksperten shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtues, me datën 07 qershor 2017, i dorëzon, panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku ne raport lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet: "*Sa i përket arsyes pare te eliminimit qe nuk kemi ofruar certifikata EN, vlen te theksohet se Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te Nenit 72 te LPP-se sepse duke u bazuar ne ketë ligj AK ka mundur te kërkoj dokumente sqaruese, pasi qe ne kemi paraqitur ne dosjen e tenderit certifikata EN nga kompania "GE Lighting" por i kemi paraqitur ne gjuhen Italiane*", sqaron se OSHP-ja, konkretisht paneli shqyrtues ka nxjerrë: vendim PSH. nr. 81/17, 86/17.91/17, më dt. 02 maj 2017, ku përmes të njëjtit vendim ka konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, tani operatorit ekonomik ankues "PEVLAKU", lidhur me kërkesën e specifikuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së ku kërkohet: *Operatori Ekonomik duhet të prezantoj certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara – sipas annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme (vlen për OE fitues),* nuk ka ofruara dëshmi për certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara, konform kërkesës së FTD-së.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: " *Sa i përket arsyes se dyte te eliminimit keni dorëzuar trupa ndriçues me jetëgjatësi me te vogël se sa qe është kërkuar ne dosje tenderit, Deklarojmë se Prodhuesi për Trupat Ndriçues, "GELighting", (Address: Vdei lit 77.1044 Budapest Hungary) plotëson normat e kërkuara te cilat do ti gjeni bashke lidhur te dokumentuara me Deklaratën e Konformitetit dhe Te dhënat Teknike për produktet e ofruara*", ekspertja shqyrtues sqaron se po ashtu edhe lidhur me pretendimin ankimor që ndërlidhet me jetëgjatësinë e trupave ndriçues, paneli shqyrtues ka nxjerrë: vendim PSH. nr. 81/17, 86/17.91/17, më dt. 02 maj 2017, ku përmes të njëjtit vendim ka konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, tani operatorit ekonomik ankues "PEVLAKU", nuk ka ofruar Jetëgjatësia e lampë ndriçuese LED >100.000, ashtu siç janë kërkuara në specifikimin teknike, por e ka ofruar GE lighting tipi SLBT, 64000h.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: "*Sa i përket arsyes trete të eliminimit keni dorëzuar katalogë ne gjuhe jo zyrtare – Italiane*", ekspertja shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik që ndërlidhet me katalogë që është ofruar në gjuhën italiane, paneli shqyrtues ka nxjerrë: vendim PSH. nr. 81/17, 86/17.91/17, më dt. 02 maj 2017, ku përmes të njëjtit vendim ka konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, tani operatorit ekonomik ankues "PEVLAKU", ka ofruar katalogun për sinjalistik vertikale nga kompania "VERNISOL" Itali, në gjuhën italiane me shenja të komunikacionit, që është ne kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 të LPP-së, ku thuhet "*Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze*".

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomin ankues ku thuhet: "*AK-ja shkelur nenin 108/A të LPP-së, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve*", ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues me dt. 12 maj 2017, ka parashtruar pranë autoritetit kontraktues kërkesën për rishqyrtim. Ndërsa, autoritetit kontraktues konform nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, me dt. 12 maj 2017, merr vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke theksuar edhe arsyet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues, të cilin vendim e ka nënshkruar udhëheqja e zyrës së prokurimit znj Albana Bakalli.

Bazuar në atë që u tha më lartë, si dhe duke pasur parasysh faktin se për të njëjtat pretendime ankimore të operatorit ekonomik ankues është vendosur me vendimin e PSH-së Nr. . 81/17, 86/17.91/17, më dt. 02 maj 2017, si rezultat i ankesave të parashtruara nga OE "Lika Trade" sh.p.k. nga Deçan, OE "Euroasphalt" sh.p.k . nga Gjakovë dhe OE N.N.T.SH. "Drini Company"sh.p.k. nga Prizren kundër njoftimit për dhënie të kontratës, të dt. 17.03.2017, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues ta hedhë poshtë si të pa lejuar, ndërsa të aprovoj vendimi e autoritetit kontraktues njoftim për dhënie të kontratës të dt. 08.05.2017.

Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, përmes parashtresës me shkrim të dt. 07 qershor 2017, e njofton panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të dt. 13 qershor, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, të dhënë në raportin e ekspertizës së dt. 07 qershor 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i rivlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues, i dt. 07 qershor 2017, si dhe parashtresën e autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues.

Ekspertja shqyrtues gjatë seancës dëgjimore deklaroj: pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ashtu siç kam konstatuar në raportin e ekspertizës, i propozoj panelit shqyrtues të hedhë poshtë si të palejuar ankesën e operatorit ekonomik ankues dhe të vërtetohet vendimin i autoritetit kontraktues njoftim për dhënie të kontratës.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së, paneli shqyrtues sqaron është përgjegjësi dhe drejtë e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarim me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tyre apo jo, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertes shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorit ekonomik ankues, parashtresës me shkrim të operatorit ekonomik ankues, parashtresës me shkrim të autoritetit kontraktues, si dhe duke pasur parasysh faktin se operatori ekonomik ankues nuk ka mund të dëshmoj interes juridik material konform nenit 111 par. 1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP-së, pasi i njëjti është i papërgjegjshëm, konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka –pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – OE "PE-VLA-KU" sh.p.k. me seli në Prishtinë
1x1 ekzemplar - AK- Komuna e Gjilanit
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së
1x1 ekzemplar- Për publikim ueb. faqe